

Gjuha shqipe

Rahman Paçarizi*

Përmbledhje

Gjuha shqipe është gjuhë indoevropiane, e cila konsiderohet, nga shumica e përfaqësuesve të gjuhësisë krahasimtare, pasardhëse e drejtpërdrejtë e ilirishtes së vjetër. Trualli i formimit të gjuhës shqipe besohet të jetë përafërsisht territori në të cilin ajo aktualisht shtrihet, ndoshta me një zhvendosje kah veriu. Nuk ka asnjë dyshim madje që Dardania, apo Kosova e sotme, është vendi ku shqipja apo protoshqipja ka pasur një kontinuitet të pandryshuar deri në ditët e sotme.

Gjuha shqipe ka dy dialekte kryesore – dialektin verior apo gegërishten dhe dialektin jugor apo toskërishten, të cilat ndahen nga një rrip gjuhësor i njohur si të folmet kalimtare. Dallimet ndërmjet dy dialekteve të shqipes janë të natyrës fonetike para së gjithash, por ka edhe disa dallime të vogla dialektore. Gjithsesi këto diete janë të ndërkuptueshme mes vete.

Dokumenti i parë i shkruar në gjuhën shqipe i zbuluar deri më tash është “Formula e Pagëzimit” e shkruar nga Pal Engjëlli më 1462.

Gjuha shqipe ka përjetuar dy standardizime zyrtare. Fillimisht më 1920 në Kongresin Arsimit të Lushnjës ishte vendosur që e folmja e Elbasanit, e folme e gegërishtes veriore, të ishte gjuhë zyrtare shqipe, ndërsa më 1972 u mbajt Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, me ç’rast në bazën e standardit të shqipes u vu përfundimisht toskërishtja.

Gjuha shqipe sot flitet nga më se 7 milionë shqiptarë në Shqipëri, Kosovë, Maqedoninë Perëndimore dhe në pjesët jugore të Malit të Zi. Dialektet arvanite në Greqinë veriore konsiderohen pothuajse gjuhë e vdekur, ndërkohë që variante të shqipes fliten në Italinë Jugore, më saktësisht në Sicili dhe Kalabri, në Zarë të Dalmacisë, Kroaci, në disa fshatra të Ukrainës dhe në Mandricë të Bullgarisë. Koloni prej miliona

* Prof. Ass. Dr. Rahman Paçarizi, Universiteti AAB, Universiteti i Prishtinës, Republika e Kosovës, rahman.pacarizi@universitetiaab.com

banorësh, të përbëra nga shqiptarë që ishin shpërngulur atje nga Kosova e Maqedonia pas Luftës së Dytë Botërore, jetojnë sot në Turqi.

Fjalët kyç: arbresh, arbër, arbëresh, arvanite, elbanishtet, Gadishulli Ballkanik, gegë, gegërishte, gjuha standarde, gjuha shqipe, gjuhësi krahasimtare, gjuhë indoevropiane, Komisia Letrare e Shkodrës, Kongresi Arsimor i Lushnjës, Kongresi i Drejtshkrimimit, Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni, protoshqipja, sociolinguistika, Shqipëri, toskë, toskërishte.

Origjina indoevropiane e shqipes

Kur Franz Boppi, aty nga mesi i shekullit XIX, e kishte renditur shqipen në mesin e gjuhëve indoevropiane, kishte qëndrime kundërthënëse për prejardhjen e shqipes dhe për vendin e saj. Bopp, e më pas edhe Pedersen, Meyer, Jokl, e deri te Hamp, duke shfrytëzuar metoda të gjuhësisë krahasimtare dhe duke u marrë me etimologjinë e fjalëve të shqipes së sotme dhe me studimin e dokumenteve të vjetra të shqipes, thanë përfundimisht se gjuha shqipe ishte një nga gjuhët indoevropiane. Kjo dëshmohet nga sistemi gramatikor i shqipes dhe nga një radhë ndërrimesh të rregullta fonetike të cilave u është nënshtruar shqipja e sotme, e që dëshmojnë një gjenezë të përbashkët të këtyre fjalëve me fjalë tashmë të dëshmuara të origjinës indoevropiane. Kundërthëniet lidhur me shqipen mund të kenë origjinën në mungesën e dëshmive të shkruara në shqip. Sidoqoftë, origjina indoevropiane e shqipes tashmë nuk është origjina indoevropiane e shqipes tashmë nuk është çështje për të cilën diskutohet, meqë, një origjinë a po përkatësi e tillë e shqipes është dëshmuar katërçipërisht, pikërisht përmes origjinës së saj. *Pak kohë pas themelimit të gjuhësisë historike krahasimtare, kryesisht për meritë të Franc Boppit, u konstatua, aty nga mesi i shekullit të kaluar, se shqipja hyn në familjen e gjuhëve indoevropiane,*¹ shkruante Eqrem Çabej, gjuhëtari shqiptar që vuri themelet e gjuhësisë historike, për t'u pasuar nga Selman Riza, Idriz Ajeti, Besim Bokshi, Shaban Demiraj, Rexhep Ismajli etj.

¹ Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore V*, Rilindja, Prishtinë, 1975.

Ndërkohë, Eric Hamp, një ballkanist amerikan më 1974 në një punim botuar në "Encyclopaedia Britannica", shkruante: *Shqipja është një gjuhë indoevropiane që flitet nga 2 milionë e 500 mijë banorë në bregut lindor të Adriatikut në Shqipëri e po ashtu edhe në Jugosllavinë fqinje, para së gjithash në Kosovë dhe Maqedoni, në Perëndim të vijës së Leskovcit e deri te Liqeni i Ohrit.*²

Detajet e pikëtakimeve të shqipes me gjuhët e tjera indoevropiane qenë elaboruar përveçse nga Boppi, edhe nga Meyeri, ndërkohë që stërhollime të mëtejshme janë bërë nga Pedersen e Jokli para së gjithash. Mirëpo, ka pasur edhe polemika të shumta në fund të shekullit XIX lidhur me shqipen e më të njohurat janë ato ndërmjet Meyer-it dhe Weigand-it, me ç'rast ky i fundit ishte vënë kundër tezave që mbështesnin origjinën indoevropiane të shqipes. Pohimet e njohura si "Dymbëdhjetë Tezat e Weigandt-it"³ për origjinën e shqipes dhe vendin e formimit të kësaj gjuhe, u hodhën poshtë nga Meyer-i, një gjuhëtar austriak, i cili kishte studiuar etimologjinë e fjalëve të shqipes, por edhe nga Pedersen, e sidomos nga Hahni. Mirëpo, edhe Meyer u kundërshtua nga Pedersen në një shkrim të vitit 1917 për revistën "Ylli i mëngjezit" për shkak se Meyer kishte thënë se pjesa më e madhe e fondit leksikor të shqipes ishte e huazuar dhe nga 5140 grupe fjalësh vetëm 400 kishin origjinë të pastër indoevropiane. Pedersen ishte mbrojtës i tezës së secila gjuhë ka në vete huazime nga gjuhët e tjera, por e ka edhe një fond të caktuar leksikor që e bën atë të jetë një gjuhë më vete. Duke kundërshtuar Meyerin dhe ndonjë gjuhëtar tjetër, danezi Pedersen thotë se *Pik së pari lermëni të thom se gjuha shqipe është një gjuhë me një tip të veçantë afërimi që ka me gjuhën të Sllavëveve ose të Grekëveve është gjithë aqë i larkmë sa afërimi që ka me gjuhën e Danezëveve ose të Persianëveve.*⁴

Është e vërtetë gjithsesi që shqipja e sotme ka në fondin e saj leksikor shumë ndikime nga gjuhët e tjera, sidomos nga ato fqinje. Mirëpo, një gjë e tillë është krejt e natyrshme kur kihet parasysh historia e Ballkanit dhe konfiguracioni etnik i tij.

² Eric P. Hamp, *Studime krahasuese për shqipen*, ASHAK, Prishtinë, 2007.

³ Balkan-Archiv III (1927) 27-251 (cit. sipas Çabej, vep. cit.).

⁴ Prof Holger Pedersen, on "The Albanian language", *Ylli i Mëngjezit*, (citar këtu sipas: Holger Pedersen, *Studime për shqipen*, ASHAK, Prishtinë, 2003.).

Në anën tjetër, është krejt e qartë që shqipja nuk ka marrë fare apo ka marrë tepër pak nga gjuhët e tjera në çështje të gramatikës. Gjuha shqipe, ka shfrytëzuar elementet dhe mjetet e saj të brendshme gramatikore e sintaksore, për t'iu përgjigjur nevojave të brendshme të gjuhës për të ndryshuar dhe nevojave shoqërore, në shërbim të të cilave është gjuha si e tillë. Kjo, apo një pjesë e këtij zhvillimi të brendshëm të shqipes, që shpjegon njëkohësisht edhe origjinën indoevropiane të saj, por edhe disa kërkime të saj me gjuhë ballkanike para së gjithash, shpjegohen qartësisht dhe thellësisht nga Besim Bokshi në studimet e gjata: *Ndryshimi i strukturës së temave emërore të shqipes* (1971), *Prapavendosja e njëjës në gjuhët ballkanike* (1980) dhe *Rruga e formimit të fleksionit nominal në gjuhën shqipe* (1984).⁵

Sidoqoftë, shpjegimin për pohimet e gabueshme lidhur me shqipen, mbështetur mbi praninë e huazimeve, e ka dhënë qartësisht Eric Hamp: *Për shkak të ndryshimeve sipërfaqësore në pamjen fonetike të gjuhës gjatë 2.000 vjetësh dhe për shkak të huazimit të fjalëve nga kulturat fqinje, vazhdimësia e trashëgimisë indoevropiane në shqipen është nënvlerësuar*.⁶

Gjithsesi, tani kur origjina indoevropiane e shqipes nuk kontestohet në qarqet serioze gjuhësore, flitet dhe është folur edhe në të kaluarën për lidhjet e mundshme të shqipes me gjuhë të tjera. Gjuhëtarë si Bartoli e Jokli e mbështesnin tezën e afrisë së shqipes me baltishten, ndërsa Pedersen kishte theksuar në punimet e tij të hershme atë të shqipes me armenishten. Sidoqoftë, pohimet e tilla dukej të mos e kishin parasysh faktin që fjalë apo formante të caktuar të indoevropishtes së vjetër mund të kenë stagnuar në një fazë të caktuar për shkak të rrethanave sociolinguistike, për shembull mund të mos kenë pasur nevojë që t'u përshtaten nevojave shoqërore të gjuhës dhe nuk u janë nënshtruar proceseve të caktuara historiko-gjuhësore. Më vonë, sipas Eric Hamp, Jokli kishte gjetur afri të shqipes me keltishten, ndërsa Weigand thoshte se shqipja ka lidhje të ngushta me trakishten. Gjuhëtarë

⁵ Këto vepra janë botuar në Prishtinë dhe ribotuar disa herë.

⁶ Eric P. Hamp, *Studime krahasuese për shqipen*, ASHAK Prishtinë, 2007, f.103 (botuar për herë të parë në *Encyclopedia Britannica Inc.*, the Fifth Edition, Helen Hemingway Benton Publisher, 1974, f. 422-423.).

të tjerë thjesht e kanë mbrojtur tezën se shqipja ishte pasardhëse e ilirishtes së vjetër dhe Hamp⁷ i sheh këto pohime si shumë më seriozisht të argumentuara. Gjuhësia shqiptare sot e ka përqafuar gjerësisht tezën për shqipen si pasardhëse të ilirishtes së vjetër, ndërkohë që këto nuk mund të argumentohen përmes dokumentesh të shkruara, por më shumë përmes mjjetesh të gjuhësisë historike, përmes arkeologjisë, shtrirjes së ilirëve e rrjedhimisht edhe të gjuhës së tyre ilirishte, e cila përkon me shtrirjen aktuale të shqiptarëve, apo me mundësinë e shpjegimit të toponimeve në zonat ku janë shtrirë ilirët vetëm përmes gjuhës shqipe, siç është rasti me emrin e Dalmacisë dhe fisit ilir që kishte jetuar atje, *dalmatët*, apo *delmatët*, origjina e të cilit mund të shpjegohet vetëm përmes shqipes.

Argumenti tjetër i Hamp-it, i përqafuar nga shkencë shqiptare, është se *shqipja nuk shfaq asnjë afri të ngushtë të veçantë me ndonjë nga gjuhët indoevropiane; ajo është plotësisht i vetmi i mbijetuar modern nga nëngrupi i saj*.⁸

Origjina e emrit të shqiptarëve

Shqiptarët, grekët dhe gjermanët mund të jenë të vetmit popuj evropianë të cilët veten e quajnë me emër tjetër nga ai me të cilin i njohin popujt e tjerë. Eqrem Çabej, një nga gjuhëtarët emblematikë shqiptarë, përafërsisht kështu e nis punimin e tij për emrin nacional të shqiptarëve.⁹ Sipas tij, shqiptarët janë ndër të paktët popuj të Evropës dhe më gjerë që kanë dy emra nacionalë, një për përdorim të brendshëm dhe tjetrin me të cilin njihen nga bota e jashtme.

Shqiptarët i thonë vetes *shqiptar-ë*, vendit të tyre *Shqipëri*, ndërsa gjuhës së tyre *gjuhë shqipe*, kurse nga të tjerët njihen me emërtimet e tyre të vjetra- vendi *Albania*, *Albanie*, e pjesëtarët e këtij kombi quhen, rrjedhimisht, *albanian*, *albanais*, *albaner* etj., ashtu si dhe gjuha e tyre.

⁷ Po aty.

⁸ Po aty.

⁹ Vep. cit., Prishtinë, 1988.

Shqiptarët e quanin veten *arbër / arbën*, apo *arbëresh / arb(ë)nesh*, gjuhën e tyre *arbërishte*, ndërsa vendin e tyre *Arbëri*, apo *Arb(ë)ni*, ndërkohë që, siç shpjegon Çabej, këtë emër nacional shqiptarët do ta kenë përdorur deri vonë, meqë ngulimet shqiptare jashtë Ballkanit përdorin për veten ende emërtimet e vjetra për gjuhën, vendin dhe përkatësinë e tyre kombëtare. Për shembull, shqiptarët e Italisë Jugore që u shpërngulën atje gjatë shekujve XV e XVI veten e quajnë *abëreshë*, gjuhën e tyre *arbërishte*, ndërsa vendin e tyre të origjinës *Arbëri*. Madje, edhe shqiptarët që kanë themeluar një koloni në Zarë të Kroacisë, fshatin e tyre e quajnë *Arbnesh*, edhe pse janë shpërngulur atje në gjysmën e parë të shekullit XVIII nga Malësia e Madhe në veri të zonave shqiptare, tash nën administrimin e Malit të Zi. Po ashtu, edhe në dokumente të shkruara në shqip në shekujt XVI e XVII, vendi del rregullisht me emrin *Arbënë*, populli me *arbëresh*, *arbëruer*, gjuha e tij me *arbërisht*.¹⁰

Krejt këto të dhëna dëshmojnë se emri nacional që shqiptarët përdorin sot për veten, vendin dhe gjuhën e tyre ka një origjinë relativisht të re. Mirëpo, pavarësisht nga origjina relativisht e re, nuk është as sot e kësaj dite e qartë se si arriti të ndryshohej aq shpejt emri nacional i shqiptarëve dhe as origjina kuptimore dhe etimologjike e emërtimit të ri që morën shqiptarët.

Përpyekjet për ta shpjeguar prejardhjen e emrit të ri nacional të shqiptarëve shin kryesisht joshkencore. Çabej hodhi poshtë, më 1972,¹¹ të gjitha pohimet e deriatëhershme që emrin shqiptar e lidhnin me emrin e shpendit që ishte simbol në flamurin dhe stemën e Skënderbeut dhe pothuajse përshkonte gjithë heraldikën e shqiptarëve, meqë, gjithnjë sipas Çabejt, fjala *shqip*, për gjuhën shqipe dhe fjala *shqipe* për zogun janë fjalë të ndryshme dhe nuk kanë burim të njëjtë. Ai hedh poshtë, po ashtu, supozimet se emri i ri nacional i shqiptarëve rridhte nga fjala *skippeto* e greqishtes së re që kishte kuptimin *pushkatar*, ashtu siç hodhi poshtë edhe pohimet se emërtimi për gjuhën shqipe vinte nga latinishtja *excipio*, meqë kjo fjalë, sipas tij, nuk e

¹⁰ Po aty, f. 69.

¹¹ Eqrem Çabej, "Emrat nacionale të shqiptarëve", në *Shqipëria e re*, 1/1972, viti XXVI, Tiranë (cituar këtu nga *Studime gjuhësore V*, 1988).

kishte kuptimin *kuptoj*, por kuptimin e “përrjashtimit, vënies mënjane”.

Prandaj, qoftë momenti vendimtar për ndryshimin e emrit nacional të shqiptarëve, qoftë origjina dhe kuptimi i atij emri, madje edhe arsyeja për përhapjen aq të shpejtë të këtij emri për përdorim të brendshëm, mbeten çështje të hapura për gjuhësinë historike, për sociologjinë dhe për sociolinguistikën.

Vendi i shqipes dhe i shqiptarëve

Si shumëçka lidhur me shqipen dhe shqiptarët që u është nënshtruar diskutimeve të shumta dhe kundërthënëse, shpeshherë me motive politike, ashtu edhe diskutimet për vendin e formimit të gjuhës shqipe, apo paraardhëses së saj. Siç vëren me të drejtë Çabej, historianët, duke mos pasur mjaft argumente për të dëshmuar vendbanimet e komuniteteve të ndryshme dhe lëvizjet e popullsisë dhe, rrjedhimisht, vendin e formimit të gjuhëve të caktuara, këtë punë ua kanë lënë gjuhëtarëve, në mënyrë që të merren me të përmes mekanizmave të gjuhësisë historike.

Sa i përket vendit të formimit të gjuhës shqipe, rrjedhimisht edhe prejardhjes së saj, pra paraardhësit gjuhor të shqipes, ka pasur dhe ka diskutime të shumta dhe janë disa grupe shkencëtarësh që këtë vend formimi e vendosin në hapësira të ndryshme. Sipas Çabejt, dija historiko-gjuhësore e vë shqipen në një pozicion ndërmjet Perëndimit dhe Lindjes, meqë zhvillime fonetike dhe gramatikore çojnë në një përfundim të tillë. Përkatësia grupit satem dhe jo atij kentum, edhe pse ka disa përkime edhe për një përkatësi të tillë, si dhe fakti që emrat e maleve si Karpatet mund të shpjegohen vetëm përmes shqipes, e vë shqipen më në Lindje, ndërkohë që alternimi *e-i* si tek fjalët *vret-orit* shkon më afër me gotishten dhe me latinishten.

Një teori që ka nxitur shumë reagime dhe në njëfarë mënyre ka nxitur jo vetëm një debat shkencor, por ka përshpejtuar hulumtimet e shkencëtarëve që mbronin tezat për Ballkanin Perëndimor dhe Veriperëndimor si djep i formimit të shqipes që të gjenin argumente të mjaftueshme për të rrëzuar

dymbëdhjetë tezat e Weigandit në favor të tezave të tyre. Tezat e Weigandit janë refuzuar nga Jokli, janë kundërshtuar nga Ribezzo, Cimochoowski e Mihaescu dhe Meillet. Çabej u dha përgjigje pothuajse refuzuese të gjitha tezave të Weigandit, sipas të cilit dilte që shqipja kishte një origjinë nga trakishtja apo nga trako-dakishtja dhe ishte formuar në trekëndëshin ndërmjet Nishit-Sofjes dhe Shkupit.

Kështu Çabej ishte ai që mbrojti dhe argumentoi tezën e një kontinuiteti etnik dhe territorial të shqiptarëve, që janë pasardhës të ilirëve të vjetër. Madje, Çabej nxjerr argumente të shumta se shqiptarët dhe paraardhësit e tyre kanë jetuar që nga Antika në zonën bregdetare. Ai ka hedhur poshtë pohimet e Weigandit për mungesën e leksikut të detarisë në shqip, duke dhënë si argumente fjalët det dhe anije, të cilat janë fjalë të shqipes së vjetër që përdoren edhe sot.

Megjithatë, gjykime më gjakftohta duket të ketë dhënë Eric Hamp, gjuhëtar amerikan, i njohur për revidimin e gjykimeve të tij në pajtim me gjetjet shkencore më të reja. Ai i ka sjellë në mënyrë të përmbledhur teoritë lidhur me vendin e formimit të shqipes.¹² “Është e qartë se në Mesjetë shqiptarët shtriheshin më në veri (Jokl, *Albaner*), se ka argumente të besueshme që janë shtruar kundër përhapjes së tyre deri në Bregun e Adriatikut: fakti se emri Scodra (Shkodër) dëshmon zhvillim jo të shqipes se nuk ka një vokabular të dëshmuar të vjetër detar dhe se ka pak huazime të lashta greke (Jokl); dhe se ka argumente në favor të Dardanisë së Vjetër[...]”.¹³

Pavarësisht nga komentimi kritik i punimeve të autorëve të ndryshëm, Hamp nxjerr përfundimin se shqipja ka origjinë të pastër indoevropiane (duke përqafuar argumentimet e Bopp-it nga 1845 dhe detajet e pikëtakimeve të shqipes me gjuhët indoevropiane nga Meyeri më 1880 dhe 1890, si dhe ato nga Pedersen dhe Jokl). Ajo që bën shumë përshtypje në gjithë këto diskutime për dhe kundër vendit të formimit të shqipes, është se askush nuk e konteston rajonin e Dardanisë (Kosova e

¹² Eric P. Hamp, *vep. cit.* ASHAK, Prishtinë, 2007, f.115-145 (origj. Eric. P. Hamp, *The Position of Albanian*, Henrik Birnbaum/Jaan Puhvel eds., *Ancient Indo European Dialects*, Berkley/ Los Angeles, 1966, f. 97-121.

¹³ Po aty, f. 117-118.

sotme) si vendin ku kanë jetuar paraardhësit e shqiptarëve, gjë që është argumentuar katërçipërisht e qëndrueshme nga toponimet, nisur, para së gjithash, që nga emri i vendit *Dardani*, që vjen nga emri *dardhë*. Po ashtu, as argumentet kundër pranisë së folësve të shqipes apo gjuhës paraardhëse të saj në zonat ku edhe tash jetojnë shqiptarët, janë tepër të zbehta dhe politikisht të motivuara, apo në rastin më korrekt nuk kanë marrë parasysh parametrat sociolinguistikë. Tani, para sociolinguistikës si një shkencë e re që është, e cila ishte ende e pakonsoliduar në kohën kur u zhvilluan diskutimet dhe argumentimet lidhur me natyrën e shqipes, mbeten detyra të rëndësishme për të shpjeguar natyrën dhe kahun e huazimeve të shqipes me gjuhët fqinje, duke pranuar dhe reviduar në ndonjë masë edhe ligjet aktualisht të njohura të deviacionit të zanoreve dhe bashkëtingëlloreve indoevropiane në gjuhët pasardhëse. Në këtë rrafsh, një ndihmesë të madhe do të jepte vetë historia, duke shpjeguar natyrën dhe motivet e lëvizjeve masive të popullsisë, me çka këto dy shkenca, duke shfrytëzuar edhe të dhënat arkeologjike e madje edhe antropologjike për të arritur përfundime serioze dhe të qëndrueshme.

Dialektet e shqipes

Gjuha shqipe ka dy dialekte kryesore të ndara gjeografikisht në dy rajone më të mëdha; dialekti verior apo gegë dhe dialekti jugor apo toskë. Folës të gegërishtes janë rreth dy të tretat e folësve të shqipes. Interesante për studimet e gjuhëtarëve dhe për afërsinë e këtyre dy dialekteve kryesore është një zonë e ndërmjetme kalimtare, e folmja e të cilës pjesë njihet me emrin të *folme kalimtare*, që shtrihen përkatësisht në pjesën veriore të toskërishtes dhe në pjesën jugore të gegërishtes, në një zonë në brigjet e lumit Shkumbin.

Dy dialektet kryesore të shqipes janë të ndërkuptueshme ndërmjet vete dhe dallimet kryesore ndërmjet tyre janë të natyrës fonetike, por ka edhe disa dallime gramatikore, kryesisht të natyrës morfologjike. Ndërkohë, ndryshimet në sintaksë janë pothuajse të papërfillshme. Dallimet në leksik në forma supletive janë të kushtëzuara nga kushtet dh rrethanat e

ndryshme në të cilat kanë jetuar pjesëtarët e këtyre arealeve dialektore të së njëjtës gjuhë. Në fushë të leksikut ka ndodhur njëfarë lloj ndryshimi ndërmjet zonave administrative politike që janë zhvilluar të ndara për më shumë se 50 vjet, pa pasur asnjë mundësi komunikimi të drejtpërdrejtë. Komunikimi ndërmjet Shqipërisë, për shembull, dhe shqiptarëve që jetonin në Jugosllavinë e atëhershme, përkatësisht në Kosovë, Maqedoninë Perëndimore dhe në Jugun e Malit të Zi, ishte një komunikim i një kahu që nuk mund të ndërtonte marrëdhënie huazimesh. Madje, nuk ndodhte as ai lloj huazimi kulturor mikrostruktural, me ç'rast gjuhë dhënëse do të ishte ajo që do të arrinte të mbizotëronte përmes masmedias, meqë zhvillimi kulturor i Shqipërisë komuniste ishte një zhvillim kulturor i shkëputur nga zhvillimet jashtë Shqipërisë, që nuk i siguronte asaj mundësinë e të qenit rrezatuese e kulturës, përmes së cilës ushtrohet edhe një ndikim gjuhësor.

Dallimi i parë është ekzistimi i gjatësisë së zanoreve në gegërishten, për dallim nga toskërishtja, e cila ruan edhe disa trajta të zanoreve të gjata, në disa të folme të veçuara, mirëpo, siç shkruan Desnickaja, ky dallim nuk është e një rëndësie absolute për dallimet ndërmjet dy dialekteve të shqipes.¹⁴

Dallimi i dytë, sipas saj, është ekzistimi i vokaleve nazale në gegërishten, gjë që nuk është karakteristikë e toskërishtes, edhe pse në gegërishten, në disa të folme, nazaliteti zbehet dukshëm. Kjo kundërvënie nazale-orale përbën, sipas Desnickajës, njërin prej elementeve më diferencuese ndërmjet dy dialekteve të shqipes, ndërkohë që Gjinari citon Dilo Sheperin të ketë thënë se zanore hundore ka edhe në disa vise të Shqipërisë Jugore, por të dhënat dialektore të asaj kohe nuk e kanë vërtetuar këtë, si në Kurvelesh e në Himarë. Ndërkaq, Menela Totoni thotë se ka vërejtur fenomenin e hundorësisë edhe në një të folme të skajshme jugore, në katundin Borsh.¹⁵ Kjo do të thotë që në një të kaluar jo shumë të largët hundorësia do të ketë ekzistuar në të dyja dialektet, si pasojë e kalimit nga zanorja e gjatë e indoevropishtes dhe e konsonantes nazale në pozicion para

¹⁴ *Gjuha shqipe dhe dialektet e saj*, Prishtinë, 1972, f. 36.

¹⁵ "E folmja e bregdetit të poshtëm", *Studime Filologjike I*, Tiranë, 1964, f. 136.

vokalit të nazalizuar. Prandaj, në kohën kur kjo veçori ekziston në formë sado të zbehtë edhe në dialektin tjetër, ajo nuk mund të përbëjë “veçorinë më diferencuese ndërmjet dy dialekteve”, por sigurisht njërën prej veçorive më diferencuese.

Si element të tretë dallues, Desnickaja përmend zanoren *â* hundore të gegërishtes, të cilës i përgjigjet një *ë* orale e ngritjes së mesme në toskërishte. Mirëpo, thotë Desnickaja, rëndësia absolute e kësaj veçorie zvogëlohet meqë në pjesë të ndryshme kjo zanore e nazalizuar labializohet në gegërishten dhe shkon më shumë kah *o*-ja. Ajo madje “harron” të merret me një çështje tepër të rëndësishme që e rrit përsëri rëndësinë e zanores *â* hundore të gegërishtes, që është vlera fonologjike e hundorësisë. Pikërisht hundorësia përbën kundërvënien kuptimore në disa fjalë të shqipes. Krahaso, për shembull, asht (emër, ashti) – *â*sht (me a nazale si folje) me korresponduesen është në toskërishte). Ose kundërvënien e hundorësisë edhe te vokalet e tjera, si te koha e tashme e foljeve *zë* dhe *ziej* në zgjedhim jovepror për të gjitha vetat e të dy numrave, *zihem* (ziej) – *zihem* (zë, kap) etj. Duke përmendur më pas dallimet e togjeve të zanoreve, që ajo i quan diftongje *ua* (tosk.) – *ue, u* (geg.), dhe reduktimin e vazhdueshëm të *ë*-së në gegërishte, Desnickaja, edhe pse e vlerëson si njërin prej dallimeve më esenciale ndërmjet dialekteve, e lë të renditur të shtatin rotacizmin, si proces që ka përfshirë vetëm toskërishten e jo edhe gegërishten. Rotacizmi në shqipen është një fenomen që besohet të ketë pushuar së vepruari në shqipen diku në shekullin VII dhe kishte prekur vetëm toskërishten. Ky fenomen ka ndikuar në shndërrimin e *n*-së intervokalike në *r*.

Edhe Jorgji Gjinari më 1966 përmend këto dallime, duke mos i klasifikuar për nga rëndësia diferencuese e tyre, madje, asnjërin nga këto elemente. Mirëpo, për dallim nga Desnickaja, Gjinari përmend edhe një element tjetër dallues në sferën e fonetikës ndërmjet dy dialekteve kryesore - theksin. Sipas tij, në dialektin verior në përgjithësi është ruajtur ligji i rregullimit mekanik të theksit në fjalët e huazuara prej turqishtes: **tenéqe** – teneqé, **shishe** - shishé, **tenxhére** - tenxheré, **penxhére** – penxheré etj., ku te fjala e huazuar nuk ruhet theksi oksiton i turqishtes, por vihet theksi paroksiton që përkon me natyrën e gjuhës shqipe. Mirëpo, Gjinari vëren se edhe në toskërishten fjalët **bòjë**, **séfte** dhe **òdë**,

kanë theks paroksiton, ndërkohë që edhe disa fjalë të huazuara turke, në gegërishten përdoren me theks oksiton si **kalà, dynjà, sinì** etj.¹⁶

Në dallimet gramatikore, Desnickaja vëren para së gjithash dy çështje themelore, të cilat përbëjnë edhe veçori dalluese ndërmjet dialekteve. Së pari, sipas saj, në gegërishten ekziston trajta specifike e infinitivit, **me hapë, me luftu** (luftue), ndërkohë që në toskërishte kuptimet përkatëse shprehen me anën e trajtave të mënyrës lidhore: geg. **Due me luftu** (luftue) – tosk. **Dua të luftoj**. Trajtat e infinitivit gegë, sipas gjasave, dikur janë përdorur edhe në toskërishten, thotë Desnickaja, duke u mbështetur në praninë e sintagmës së ngurosur **domethënë**, prej **do me thënë**. Desnickaja, këtë dallim e sheh si një dallim më esencial gramatikor ndërmjet dy dialekteve të shqipes.

Edhe Gjinari pajtohej më 1966, e sigurisht edhe më pas,¹⁷ lidhur me dallimet gramatikore në këtë pikë. Ai shkruan se, në strukturën gramatikore dallime të rëndësishme shkaktohen nga ekzistenca e disa formave gramatikore në dialektin verior dhe mungesa e tyre në dialektin jugor. Mungojnë, në jug, përemrat pronorë vetvetorë (**e vet, e vet, të vet**), e kryera e dytë dhe e kryera e plotë e dytë (**kam pas vojt dhe kisha pas vojt**) dhe paskajorja **me shkue**, prej përdorimit të të cilëve vijnë më pas edhe diferencime në sintaksë. Dallime të tjera të qenësishme në strukturë shkaktohen prej mënyrave të ndryshme të ndërtimit të formave të disa pjesëve të ligjëratës dhe herë-herë edhe prej përdorimit sintaksor të ndonjërës prej tyre: mjaft emra mashkullorë që mbarojnë me bashkëtingëllore e formojnë shumësin në dialektin verior me mbaresën **a**, ndërsa në dialektin jugor me **ë** ose në mënyra të tjera, si **brina-brirë, dembela-dembelë, gishta-gishtërinj** etj. Një dallim tjetër përbën edhe reflektimi me mbaresë i gjinisë femërore te mbiemrat e nyjshëm, si në rastet **i lamë, e lame** në gegërishte me **i larë, e larë** në toskërishte, ku dallohen vetëm me nyjën e përparme të mashkullores apo të femërores.¹⁸

¹⁶ "Sprovë për një ndarje dialektore të gjuhës shqipe", *Studime Filologjike*, 4, Tiranë, 1966, f. 103.

¹⁷ Jorgji Gjinari, Gjovalin Shkurtaj, *Dialektologjia*, SHBLU, Tiranë, f. 173-174.

¹⁸ Jorgji Gjinari, art. cit. *Studime Filologjike*, 4, Tiranë, 1966.

Ndërkohë, Gjinari vëren se e kryera e pësoreve, përveç të folmeve të Elbasanit, në gegërishte formohet nga e pakryera e veprorëve, duke ua paravënë pjesëzën përemërore **u**, ndërsa toskërishtja ka një formë të posaçme më të thjeshtë, p.sh. **u lajsha - lahesha**, por ai nuk merr parasysh edhe shumë të folme të Kosovës, ku dominon trajta **u lahsha**, që është e afërt me trajtën e toskërishtes, por sigurisht me pjesëzën përemërore **u** përpara.¹⁹

Njohja teorike dhe praktike e së folmes dialektore të shqipes na bind se, pa marrë parasysh ekzistimin e një numri të madh veçorish diferenciale, dallimet në mes dy tipave kryesore dialektore, përgjithësisht, nuk janë aq të mëdha, siç është pohuar disa herë në të kaluarën.²⁰ Desnickaja thotë se “një kohë, prania e ndarjes dialektore është shfrytëzuar si argument kundër domosdoshmërisë së vetëvendosjes kombëtare të popullit shqiptar që ka qenë nën sundimin e Turqisë”.²¹ Me këtë rast, thotë ajo, është interesant mendimi i Maximilliam Lambertz-it, se: “dallimet në mes këtyre dy grupeve të mëdha të dialekteve nuk janë aq të mëdha, siç është vërtetuar shpeshherë (në asnjë rast nga pikëpamja linguistike) prej kundërshtarëve të albanofilëve”.²² Duke mos bërë fjalë tashmë për faktin se në mes Veriut dhe Jugut shtrihet zona e mesme kalimtare, skeleti kryesor i këtyre dy grupeve të dialekteve është aq i njësuar në pikëpamje fonetike, sintaksore dhe leksikore, sa që dallimet ndërmjet dy pjesëve të ndërtesës mund t’i shikojmë vetëm në zbulimin e mureve...

Standardizimi i shqipes

Ndryshe nga shumë gjuhë evropiane, për shkak të rrethanave historike e sociopolitike në të cilat ndodheshin shqiptarët, gjuha shqipe përjetoi një standardizim të vonshëm. Madje, edhe dokumentet e para të shkruara në gjuhën shqipe datojnë në gjysmën e dytë të shekullit XV, më saktësisht dokumenti i parë i

¹⁹ Po aty.

²⁰ Agnia Desnickaja, vep.cit. f. 40.

²¹ Po aty.

²² M. Lambertz, *Die Mundarten der albanischen Schprache und ihre Erforschung*, f. 124.

zbuluar deri më tash është *Formula e Pagëzimit* e shkruar më 1462 nga prifti katolik Pal Engjëlli, në dialektin e gegërishtes veriore. Dëshmi të tjera për ekzistimin e shkrimit shqip, ka dhënë E. Durham më 1928, e cila kishte gjetur se prifti francez Gulielm Adae në një relacion dërguar eprorëve të tij, shkruante se *Sado që shqiptarët kanë një gjuhë fare të ndryshme nga latinishtja, megjithatë kanë në përdorim në të gjitha librat e tyre shkronjat latine*. Një historian shqiptar, Musa Ahmeti, ka pohuar para disa vjetësh se kishte gjetur në Arkivat e Vatikanit një libër voluminoz në gjuhën shqipe të shkruar në fillim të shekullit XIII, por një gjë e tillë nuk është dëshmuar asnjëherë plotësisht, edhe pse Ahmeti kishte prezantuar disa faksimile në revista të Kosovës më 2005.

Përpyekjet për standardizimin e shqipes u intensifikuan vetëm në shekullin XX, edhe pse kishte përpjekje të veçanta të disa autorëve për të përdorur një standard shkrimi të letërsisë edhe më herët. Shekulli XX solli në dritë përpjekje të vetëdijshme të intelektualëve, para së gjithash nga veriu, për të pasur një shqipe standarde. Janë të njohura teori të ndryshme për rrugën që duhej të ndiqte standardizimi i shqipes, të cilat herë shkonin kah veriu (shkrimtarët dhe klerikët shkodranë) e herë kah jugu (A.Xhuvani), por kishte edhe përpjekje për një standard me bazë në Shqipërinë e Mesme, përkatësisht në të folmen e Elbasanit. Teoria për standardin e elbasanishtes si bazë e një gjuhë standarde kishte dalë nga Zef Jubani më 1871 në një përmbledhje këngësh popullore që kishte botuar në Trieshtë. Kjo teori u mbështet nga gjuhëtarë shqiptarë e të huaj si Pedersen, Nachtigali, Pekmezi, Gurakuqi e të tjerë e madje edhe nga Faik Konica, i cili kishte edhe një teori të çuditshme, por me tendencë integruese, që toskërishtja të ishte gjuhë e prozës, ndërsa gegërishtja gjuhë e poezisë. Komisia Letrare e Shkodrës më 1916-1917 e mbështeti vënien e elbasanishtes në bazë të gjuhës standarde dhe kjo u formësua në Kongresin Arsimor të Lushnjës më 1920, ku u kërkua që tekstet shkollorë të shkruheshin në elbasanishten. Argumentet pro elbasanishtes më shumë ishin të natyrës integruese dhe gjeografike, meqë kjo zonë ndodhet më afër të dyja dialekteve kryesore, edhe pse në bazën e saj ishte gegërishte jugore. Kështu, elbasanishtja u bë

gjuhë zyrtare, apo gjuhë standarde shqipe me dekret shtetëror.²³

Mirëpo, ndryshimet politike që ndodhën në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore me ardhjen e komunistëve në krye dhe vendosjen e diktaturës së Enver Hoxhës, u imponua përdorimi i toskërishtes në dokumentet zyrtare, meqë vetë diktatori Hoxha ishte nga skaji më jugor i të folmeve të shqipes. Kjo politikë, e nisur nga klasa e atëhershme politike, nisi të marrë formën e plotë dhe të mbulohej më një tis shkencor. Qysh më 1947 u formua një Komision për hartimin e Rregullave të Ortografisë së Gjuhës Shqipe i përbërë nga Kostaq Cipo, Eqrem Çabej dhe Aleksandër Xhuvani.²⁴ Projekti i hartuar prej tyre, i cili dhe nuk ishte aq larg elbasanishtes, me gjithë disa anime të thella kah toskërishtja, u sulmua nga disa gjuhëtarë si Simon Shuteriqi. Me këtë arsyetim u organizua më 1949 një konferencë më e madhe për këtë çështje dhe më 1951 u botua broshura *Ortografia e gjuhës shqipe*, e cila ishte anuar përfundimisht kah vënia e toskërishtes në bazën e shqipes standarde. Konferenca për Drejtshkrimin u mbajtën më 1952 (dy sesione në Tiranë), ndërsa në Kosovë u themelua një Komision i autorizuar të merret me çështjen e drejtshkrimit. Pastaj, më 1953, u mbajt edhe një konferencë në Tiranë. Një mbledhje për Drejtshkrimin u mbajt më 1957 në Prishtinë. Më 1967 në Tiranë u botua Projekti i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, ndërsa një vit më vonë, u mbajt mbi këtë bazë Konsulta e Prishtinës, në të cilën gjuhëtarët e asaj kohe nga Kosova i dhanë dritën e gjelbër pranimit të standardit të shqipes mbi bazën e toskërishtes. Kjo bazë dhe vënia e toskërishtes në bazën e gjuhës standarde shqipe u formalizua më 1972 në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe në të cilin morën pjesë, përveç strukturave politike të Shqipërisë dhe gjuhëtarëve të atjeshëm, edhe gjuhëtarë nga Kosova dhe nga viset e tjera shqiptare nën ish-Jugosllavinë. Përqafimi i standardit të ri të shqipes u pranua në Kosovë për shkaqe krejtësisht politike, ndërkohë që atëherë kishte pak gjuhëtarë të shkolluar, të cilët madje nuk kishin kurrfarë përgatitje

²³ "Mbi dialektin zyrtar", *Fletorja zyrtare*, Tiranë, 21 kallënduer 1923, vjeti II, nr. 3.

²⁴ Fadil Raka, *Historia e shqipes letrare*, Prishtinë, 2004, f. 203.

gjuhësore në fushë të sociolinguistikës dhe të standardizimit. Në Kosovë një gjuhë e përbashkët shqipe nuk trajtohej si fakt gjuhësor a shkencor, por si një çështje identitare.²⁵

Sidoqoftë, standardi i shqipes i miratuar në Kongresin e Drejtshkrimit më 1972 arriti gjatë më se tri dekadash të hyjë në përdorim të gjerë në shkolla dhe në përdorim zyrtar, ndërkohë që pushteti i atëhershëm në Shqipëri ishte kujdesur që të bënte një diferencim edhe ideologjik ndërmjet gjuhës standarde dhe varianteve dialektore. Po për arsye identitare, edhe pse në Kosovë asnjëherë gjuha standarde nuk ka arritur një shtrirje të gjerë përdorimi, përveç shkollës, një pjese të letërsisë dhe medias, nuk ka pasur ndonjë reaksion ndaj standardit të mbështetur mbi toskërishten, i cili nuk u reformua asnjëherë, pasi nuk kaloi nëpër fazat e njohura standarde, nëpër të cilat duhet të kalojë një standard gjuhësor për të qenë krejt funksional dhe gjerësisht i pranueshëm në domene të caktuara të përdorimit.

Sidoqoftë, çlirimi i Kosovës nga Serbia dhe pavarësimi i saj, i pushuan nevojat identitare të shqiptarëve të Kosovës për të mbrojtur një standard gjuhësor të cilin nuk arritën ta përvetësojnë mjaft asnjëherë, ndoshta më shumë edhe për shkak të mungesës së komunikimit ndërmjet shqiptarëve në Shqipëri dhe atyre në Kosovë dhe në viset e tjera nën ish-Jugosllavinë.

Bibliografi

Balkan-Archiv III 1927.

Bokshi Besim, *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*, Rilindja, Prishtinë, 1980, ribotuar nga ASHAK më 2005.

Bokshi, Besim, *Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike*, Rilindja, Prishtinë, 1984.

Bopp, Franz, *Über das Albanesische in seinen verwandtschaftlichen Beziehungen*, Kon. Preuss. Akad.d. Wiss. Berlin, 1854.

Cimochowski, Waclav, *Prejardhja e gjuhës shqipe*, BUSHT (S.Sh.Sh) 2, Tiranë, 1958.

Çabej, Eqrem, *Emrat nacionale të shqiptarëve*, Shqipëria e re, 1/1972, viti XXVI, Tiranë.

²⁵ Më gjerësisht shih: Rexhep Ismajli, *Gjuhë standarde dhe histori identitetesh*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2005.

- Çabej, Eqrem, *Studime gjuhësore I-V*, Rilindja, Prishtinë, 1975.
- Çabej, Eqrem, *Studime gjuhësore V*, Rilindja Prishtinë, 1988.
- Demiraj, Shaban, *Gramatikë historike e shqipes*, ASHSH/IGJH, Tiranë 2002.
- Desnickaja. Agnia, *Gjuha shqipe dhe dialektet e saj*, Prishtinë, 1972.
- Encyclopedia Britannica Inc.*, the Fifth Edition, Helen Hemingway Benton Publisher, 1974, f. 422-423).
- Fiedler, Wilfried, *Das Albanische Verbalsystem in der Sprache des Gjon Buzuku*, ASHAK, Prishtinë, 2004.
- Gjinari, J, Shkurtaj, Gj. *Dialektologjia*, SHBLU, Tiranë, 2000.
- Gjinari, Jorgji, *Sprovë për një ndarje dialektore të gjuhës shqipe*, Studime Filologjike, 4, 1966.
- Hamp, Eric, P. *Studime krahasuese për shqipen*, ASHAK, Prishtinë, 2007.
- Hamp. Eric. P. *The Position of Albanian*, Henrik Birnbaum/Jaan Puhvel eds., *Ancient Indo European Dialects*, Berkley/ Los Angeles, 1966.
- Ismajli, Rexhep, *Gjuhë standarde dhe histori idntitetesh*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2005.
- Lambertz, Maximilliam, *Die Mundarten der albanischen Schprahe und ihre Erforschung*,
Mbi dialektin zyrtare- Fletorja zyrtare, Tiranë 21 kallënduer 1923, vjeti II, nr. 3.
- Miklosic, Franc, *Gjurmime shqiptare/Albanische Forschungen*, ASHAK, Prishtinë, SAZU, Ljubljana, 2007.
- Pedersen Holger *On the Albanian language*, Ylli i Mëngjezit.
- Raka, Fadil, *Historia e shqipes letrare*, Prishtinë, 2004, f. 203.
- Riza, Selman, *Vepra 2 e 4m* ASHAK, Prishtinë 1997-2004.
- Totoni, Menella, *E folmja e bregdetit të poshtëm*, Studime Filologjike I, 1964.

